



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS -- PROBACIONA SLUŽBA KOSOVA
KOSOVO PROBATION SERVICE
DREJTORIA QENDRORE

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:	SHSK-MD/2023				
PËR/ZA/TO:	Znj. Albulena Haxhiu, Ministre në Ministrinë e Drejtësisë				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arsim Tahiri, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës				
NGA/OD/FROM:	Arsim Tahiri				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për aprovimin e planit zhvillimor strategjik 2023-2025				
Nr. i zyrës:	604	Lokacioni:	038 200 67 300	Data:	26/09/2023
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extensin:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input checked="" type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

E nderuara Ministre znj. Albulena Haxhiu,

Shërbimi Sprovues i Kosovës ka përgatitur Planin Zhvillimor Strategjik 2023-2025 në të cilën janë përfshirë një varg aktivitete të përmbledhura në tre (3) objektiva kryesore zhvillimore të cilat kanë për qëllim avancimin e punës së Shërbimit Sprovues drejt arritjes së objektivave zhvillimore të agjencionit në përputhje me politikat strategjike të Ministrisë së Drejtësisë.

Ky Plan Zhvillimor përmban një varg aktivitete për tre vitet e ardhshme dhe bazohet në punën që ka bërë Shërbimi Sprovues i Kosovës deri më sot dhe fuqizimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve profesionale dhe institucionale në mënyrë që të jetë një agjension profesional në mbikëqyrje të personave me dënime alternative.

Kjo strategji është përgatitur duke u bazuar në rekomandimet dhe vlerësimet e partnerëve strategjik me theks të veçantë: Ambasada e SHBA në Prishtinë, EULEX-zyra në Kosovë, OSCE - zyra në Kosovë, etj.

Andaj, bazuar në kompetencat tuaj po ju paraqesim për aprovim Planin Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues të Kosovës së bashku me Planin e Veprimit për periudhën 2023-2025.





SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS

PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK (2023-2025)

Prishtinë, Shtator 2023



FJALA HYRËSE

Kam nderin dhe kënaqësinë të prezantojmë Planin Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues të Kosovës 2023-2025. Vizioni ynë është që me punën tonë në ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative të adresojmë të gjitha çështjet sa i përket rehabilitimit, riintegritimit dhe risocializimit të kryesëve të veprave penale në komunitet. Me këtë plan strategjik të Shërbimit Sprovues po vendosim fushat tona të prioritetit, të cilat do të jenë edhe synimi kryesor përgjatë viteve 2023-2025.



Plani Strategjik i Shërbimit Sprovues të Kosovës përmban një varg aktivitete për tre vitet e ardhshme dhe bazohet në punën që ka bërë Shërbimi Sprovues i Kosovës deri më sot dhe fuqizimin e mëtutjeshëm të SHSK-së në mënyrë që të jemi agjension konkurrent me shërbimet tjera sprovuese të vendeve të rajonit.

Kjo strategji është përgatitur duke u bazuar në rekomandimet dhe vlerësimet e partnerëve strategjik si: Ambasada e SHBA-së në Prishtinë, EULEX-zyra në Kosovë, OSCE – zyra në Kosovë, etj.

Zbatimi i masave dhe dënimeve alternative, rehabilitimi, reinteigrimi dhe risocializimi, si dhe mbikëqyrja e personave të dënuar do të jenë themeli i punës që do të bëjmë. Zbatimi i Planit Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues 2023-2025 do të garantojë konsistencë, efektivitet dhe rezultate sa më të mira në kuptim të sigurisë sa më të madhe të klientëve tanë që janë pjesë e pandashme e shoqërisë sonë.

Në këtë Plan Zhvillimor Strategjik, Shërbimi Sprovues në fokus të prioritetëve të saj do të ketë bashkëpunimin profesional me institucionet qeveritare e jo qeveritare në fushat e interesit të përbashkët me qëllim të avansimit sa më të mirë të Shërbimit Sprovues dhe garantimit sa më të madh të komunitetit për një ambient të qetë dhe të sigurtë.

Ky Plan Zhvillimor Strategjik përcakton vullnetin dhe përkushtimin tonë që Shërbimi Sprovues i Kosovës të jetë efektiv, efikas, bashkëpunues dhe inovativ si në strukturën e brendshme organizative e githashtu edhe në raport me klientët tanë, komunitetin si dhe palët e interesuara në përgjithësi.

Realizimi sa më i mirë i Planit Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues do të jetësohet në një përpjekje kolektive të të gjithë personelit të Shërbimit Sprovues dhe akterëve jashtë saj në mënyrë që arritja e objektivave të jetë sa më e plotë.

ARSIM TAHIRI

Drejtor i Përgjithshëm

Shërbimi Sprovues i Kosovës

PËRMBAJTJA

AKRONIMET.....	5
I. PËRMbledhja Ekzekutive	6
Misioni	7
Vizioni.....	7
II. PARIMET E PËRGJITHSHME.....	7
III. METODOLOGJIA	8
IV. OBJEKTIVAT E PLANIT ZHVILLIMOR.....	9
Objektivi Strategjik 1: Ngritja e sigurisë në komunitet	9
Objektivi Strategjik 2: Fuqizimi i rrjetit të bashkëpunimit.....	10
Objektivi Strategjik 3: Ngritja e kapaciteteve të Shërbimit Sprovues	10
V. PLANI I VEPRIMIT	11

AKRONIMET

AD	Akademia e Drejtësisë së Kosovës
AKSP	Akademia e Kosovës për siguri Publike
BE	Bashkimi Evropian
CEP	Qendra Evropiane e Sprovimit
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KiE	Këshilli i Evropës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MD	Ministria e Drejtësisë
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
OE	Odat Ekonomike
PK	Policia e Kosovës
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Plani Zhvillimor Strategjik i Shërbimit Sprovues të Kosovë (SHSK) është rezultat i punës së madhe të zyrtarëve të SHSK-së dhe ekspertëve të angazhuar me rastin e draftimit të kësaj strategjie, por edhe e partnerëve ndërkombëtarë, si: Misioni i OSBE-së në Kosovë, Zyra e EULEX-it në Prishtinë, ICITAP etj. Shërbimi Sprovues i Kosovës përmes këtij Plani Zhvillimor Strategjik synon t'i hapet rruga drejt një shërbimi modern dhe të zhvilluar për mbikëqyrjen e personave të dënuar me dënime alternative si dhe të liruarit me kusht nga burgu.

Shërbimi Sprovues i Kosovës ka hartuar këtë Plan Zhvillimor Strategjik për të përforcuar edhe më tutje rolin e tij në sistemin e drejtësisë, si dhe për të forcuar rolin në zbatimin e dënimeve alternative në përgjithësi. Ky Plan Zhvillimor Strategjik do të kontribuojë në përforcimin e vazhdueshëm të rolit të Shërbimit Sprovues, avancimin profesional të zyrtarëve sprovues, por edhe do të udhëzojë drejtimin dhe zhvillimin e ardhshëm të SHSK-së në punën e tij me personat që kanë rënë ndesh me ligjin, si të mitur ashtu edhe madhorë.

Planin Zhvillimor Strategjik i SHSK-së siguron që zyrtarët e Shërbimit Sprovues të Kosovës t'i zbatojnë ligjet në fuqi në mënyrë adekuate dhe të respektohen të drejtat e njeriut (me personat që kanë rënë ndesh me ligjin, të mitur dhe madhorë).

Në kuadër të Planit Zhvillimor Strategjik janë përfshirë tre (3) objektiva strategjike të cilat sigurojnë përmirësimin dhe avancimin e punës së Shërbimit Sprovues.

Objektivat e parapara të Planit Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues janë:

1. Ngritja e sigurisë në komunitet
2. Fuqizimi i rrejtit të bashkëpunimit
3. Ngritja e kapaciteteve të Shërbimit Sprovues

Në kuadër të secilit objektivi strategjik janë përfshirë objektivat specifike me qëllim të arrihen rezultatet sa më të mira në përbushjen e objektivave dhe realizmin e plotë të Planit Zhvillimor Strategjik.

MISIONI

Misioni i Shërbimit Sprovues përcaktohet me Ligjin Nr.. 08/L-129 për Shërbimin Sprovues të Kosovës, i cili ka për qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin shoqëror të personave nën mbikëqyrje, gjithashtu, parandalimin e veprave penale dhe uljen e rrezikut të përsëritjes së tyre, si dhe të kontribuojë në mbrojtjen e interesit publik.

VIZIONI

Vizioni i këtij Plani Zhvillimor Strategjik është që të arrihet një komunitet më i sigurt përmes përsosmërisë në një Shërbim Sprovues të ndërtuar mbi respektimin e dinjitetit njerëzor i cili ndihmon ngritjen e sigurisë shoqërore në përgjithësi.

II. PARIMET E PËRGJITHSHME

Shërbimi Sprovues udhëhiqet nga parimet e përgjithshme si:

- Profesionalizmi, transparenca dhe përgjegjshmëria—duke qenë transparent dhe llogaridhënës për punë dhe aktivitetet ligjore, si dhe integritetin dhe respektin për të kryer detyrat të cilat i ka në mandatin e tij.
- Bashkëpunimi me partnerët me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe kreativitetit për të shërbyer me dinjitet dhe integritet.
- Respektimi i vlerave humane në kryerjen e punës me etikë profesionale – Shërbimi Sprovues të ndjek standarde të larta të sjelljes dhe të respektojë detyrat e saj me përgjegjësi ndaj klientëve dhe publikut në përgjithësi, si dhe respektimi i të drejtave për të gjithë personat me të cilët bashkëpunon.

III. METODOLOGJIA

Plani Zhvillimor Strategjik i Shërbimit Sprovues është bazuar në parimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, legjislacioni në fuqi, si dhe në instrumentet ndërkombëtare. Gjithashtu ky Plan Zhvillimor Strategjik është bazuar edhe në praktikat më të mira të institucioneve ndërkombëtare lidhur me zbatimin e dënimeve alternative, duke aplikuar standardet më të avancuara.. Procesi i planifikimit strategjik ka përfshirë konsultime gjithëpërfshirëse me palët e interesit, institucionet e tjera qeveritare të Kosovës dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë.

Hartimit të këtij Plani Zhvillimor Strategjik i kanë paraprirë edhe dokumentet tjera dhe raporte të vlerësimit të punës së Shërbimit Sprovues të hartuara nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Në këto analiza janë gjetur indikatorë të rëndësishëm që kanë shërbyer për të formuluar objektiva të cilat do të ndihmojnë Shërbimin Sprovues për të arritur rezultate duke i konkretizuar në hapa dhe veprime konkrete drejt përmbushjes së objektivave staregjike.

Metodologjia e hartimit të Planit Zhvillimor Strategjik ka përfshirë këto aspekte:

- ✓ Studime kualitative nëpërmjet fokus grupeve të caktuara;
- ✓ Grumbullim të literaturës dhe materialit të dokumentacionit brenda SHSK-së;
- ✓ Studim krahasues mes gjendjes aktuale dhe të arritjeve dhe objektivave për të ardhmen;
- ✓ Rekomandimet nga raportet mbi vlerësimin të SHSK-së të hartuara në periudha të ndryshme kohore;



IV. OBJEKTIVAT E PLANIT ZHVILLIMOR

Objektivat e Planit Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues synojnë të përmirësojnë fushveprimtarinë e mbikqyrjes së personave me dënime alternative duke u lidhur me Planin Zhvillimor Strategjik të Ministrisë së Drejtësisë e cila ka paraparë plane të vecanta të zhvillimit për agjencionet varëse. Duke u lidhur me Planin Strategjik të Ministrisë së Drejtësisë e cila synon avansimin e punës profesionale në shërbim të qytetarëve pa dallim, Shërbimi Sprovues parashih objektiva të cilat e ndihmojnë arritjen e synimeve të përbashkëta të Ministrisë së Drejtësisë por edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës në përgjithësi për sundimin e ligjit. Objektivat e Planit Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues janë:

1. Ngritja e sigurisë në komunitet
2. Fuqizimi i rrejtit të bashkëpunimit
3. Ngritja e kapaciteteve të Shërbimit Sprovues

Objektivi Strategjik 1: Ngritja e sigurisë në komunitet

Ky objektivi ka për qëllim ngritjen e sigurisë në komunitet përmes realizimit të detyrave të cilat kontribuojnë në rehabilitimin dhe risocializimin e personave të dënuar me dënime alternative. Dënimet alternative janë dëshmuar si mundësia më e mirë në procesin e rehabilitimit, reintegrimit dhe risocializimit për të gjithë personat si shkelës të ligjit dhe ndihmon në uljen e recidivizmit dhe rritjen e sigurisë publike.

Objektiv specifik 1.1: Zbatimi efektiv i masave, dënimeve alternative dhe mbikqyrjes së personave të liruar me kusht;

Objektiv specifik 1.2: Ngritja e vetëdijës dhe ndërgjegjësimit mbi përparësitë e dënimeve alternative;

Objektiv specifik 1.3: Mbështetje efektive për rehabilitim dhe risocializim të personave të dënuar.



Objektivi Strategjik 2: Fuqizimi i rrjetit të bashkëpunimit

Përmes këtij objektivi synohet të arrihet forcimi i bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale, organizatat ndërkombetare qeveritare si dhe organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare. Ky objektivi synohet të arrihet përmes objektivave specifike duke forcuar bashkëpunimin me anë të marrëveshjeve të lidhura me akterët relevant. Nevoja për të bashkëpunuar me komunitetin është domosdoshmëri e cila ndihmon në zbatimin e një numri të madh të dënimeve alternative të cilat ekzekutohen në komunitet përmes bashkëpunimit me institucionet qeveritare dhe joqeveritare.

Objektivi specifik 2.1: Forcimi i bashkëpunimit me akterët e nivelit qendror dhe lokal;

Objektivi specifik 2.2: Forcimi i bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare;

Objektivi specifik 2.3: Forcimi i bashkëpunimit me organizata joqeveritare.

Objektivi Strategjik 3: Ngritja e kapaciteteve të Shërbimit Sprovues

Objektivi strategjik 3 ka për qëllim që përmes objektivave specifike të ngris kapacitetin profesional të stafit të SHSK-së nëpërmjet trajnimeve, si dhe të përmirësoj kushtet e punës. Kjo synohet të arrihet duke avancuar sistemin e teknologjisë informative dhe mjeteve të punës të cilat do të kenë ndikim në ofrimin e shërbimeve sa më profesionale me qëllim të përmbushjes së detyrave të punës me integritet dhe profesionalizëm konform standardeve.

Objektivi specifik 3.1: Ngritja e aftësive dhe shkathtësive profesionale të stafit të SHSK-së;

Objektivi specifik 3.2: Avancimi i mëtutjeshëm i mjeteve teknologjike dhe logjistike;

Objektivi specifik 3.3: Përkrahja në mirëqeniën e stafit;

V. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit hartohet brenda kornizës së përgjithshme strategjike të përcaktuar në Planin Zhvillimor Strategjik të SHSK-së.

Plani i veprimit për zbatimin e këtij Plani Zhvillimor Strategjik përmbanë:

- 1. Objektivat strategjikë;*
- 2. Objektivat specifike;*
- 3. Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave;*
- 4. Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv dhe aktivitet;*
- 5. Afatet kohore për realizimin e secilit objektiv;*
- 6. Burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;*
- 7. Treguesit për realizimin e secilit objektiv dhe aktivitet.*

Objektivi Strategjik 1: Ngritja e sigurisë në komunitet

Objektivi specifik 1.1		Zbatimi efektiv i masave, dënimeve alternative dhe mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht				
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet	
1 Standardizimi i metodave të punës	2023-2025	Shërbimi Sprovues / MD	MD	MD/Donacion	Formularët e punës të standartizuar	
2 Standardizimi i instrumenteve për vlerësimin e rrezikut	2023 - 2025	Shërbimi Sprovues / MD	MD	MD/Donacion	Instrumenti i standartizuar	
3 Përkrahja për grupet specifike në nevojë	2023-2024	Shërbimi Sprovues/ MD	MD	MD/Donacion	Rritja e pjesëmarrjes së grupeve perfituese	

Objektivi specifik 1.2		Ngritja e vetëdijës dhe ndërgjegjësimit mbi përparësitë e dënimeve alternative				
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputt	
1	Kampanjat vetëdijësuese	2023-2025	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Sensibilizimi në komunitet i arritur
2	Promovimi i Shërbimit Sprovues në media sociale	2023-2025	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Mediat sociale të krijuara
3	Krijimi i web-it për SHSK-në	2023-2024	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Krijimi i web në finalizim e sipër.
4	Identifikimi, analiza dhe vlerësimi i nevojave për trajnime	2023-2024	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Raporti i hartuar
5	Hartimi i programit të trajnimeve	2023-2025	SHSK/MD	MD, AKSP	MD/Donacion	Plani dhe programi i trajnimit i hartuar
6	Aftësimi i trajnerëve brenda institucionit	2024-2025	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	TOT i realizuar

Objektivi specifik 1.3		Mbështetje efektive për rehabilitim dhe risocializim të personave të dënuar				
Aktivitetet	Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputt	
1.	Programet e rehabilitimit	2023-2025	SHSK/MD	MD, OJQ	MD/Donacion	Programet e zbatuara
2.	Mbështetje e klientëve	2023-2025	SHSK/MD	MD/ OJQ	MD/Donacion	Rritja e numrit të klienteve përfitues
3.	Ofrimi i shërbimeve profesionale në komunitet	2023-2025	SHSK/MD	MD/ OJQ	MD/Donacion	Shërbimet e realizuara

Objektivi Strategjik 2: Fuqizimi i rrjetit të bashkëpunimit

Objektivi specifik 2.1		Forcimi i bashkëpunimit me akterët e nivelit qendror dhe lokal				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Forcimi i bashkëpunimit me sistemin gjyqësor	2023-2025	SHSK/MD	KGJK, KPK	MD/Donacion	Bashkëpunimi me sistemin gjyqësor i arritur
2	Organizimi i tryezave të rrumbullakta	2023-2025	SHSK/MD	KGJK, KPK, AD, ASP, OAJ etj	MD/Donacion	Tryeza në zyrat rajonale të organizuara
3	Memorandume bashkëpunimi	2023-2025	SHSK/MD	KGJK, KPK, AD, ASP, OAJ etj	MD/Donacion	Marrveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara

Objektivi specifik 2.2		Forcimi i bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Pjesëmarrja në organizimet e CEP-it	2023-2025	SHSK/MD	CEP	MD/Donacion	Pjesëmarrje të rregullta
2	Organizimi i takimeve të rregullta me partnerët ndërkombëtar	2023-2025	SHSK/MD	MD/SHSK	MD/Donacion	Takime të rregullta
3	Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta	2023-2025	SHSK/MD	MD/SHSK	MD/Donacion	Aktivete vjetore të realizuara (4)
4	Organizimi i konferencave rajonale	2023-2025	SHSK/MD	MD/SHSK	MD/Donacion	Pjesëmarrje në konferenca rajonale
5	Shkëmbimi i përvojave me institucionet e sprovimit	2023-2025	SHSK/MD	MD/SHSK	MD/Donacion	Shkëmbimi i përvojave i realizuar
6	Organizimi i vizitave studimore	2023-2025	SHSK/MD	MD/SHSK	MD/Donacion	Vizitat e realizuara

Objektivi specifik 2.3		Forcimi i bashkëpunimit me organizata joqeveritare				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Pjesëmarrja në rrjetin e organizatave me të cilat SHSK bashkëpunon dhe do bashkëpunoj	2023-2025	SHSK/MD	OJQ	MD/Donacion	Pjesëmarrje e realizuar në rrjetet e OJQ-ve sic është KOMF etj.
2	Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit	2023-2025	SHSK/MD	Qendrore dhe Lokale	MD/Donacion	Marrveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara
3	Organizimi i takimeve me asociacionet ekonomike	2023-2025	SHSK/MD	OE	MD/Donacion	Takimet e realizuara

Objektivi Strategjik 3: Ngritja e kapaciteteve të Shërbimit Sprovues

Objektivi specifik 3.1		Ngritja e aftësiave dhe shkathtësiave profesionale të stafit të SHSK-së				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Identifikimi, analiza dhe vlerësimi i nevojave për trajnime	2023-2025	SHSK/MD	Qendror dhe lokal	MD/Donacion	Raporti për nevjat e trajnimit i hartuar
2	Hartimi i programeve të trajnimeve	2023-2025	SHSK/MD	Qendror dhe lokal	MD/Donacion	Planprogrami i hartuar
3	Trajnime të specializuara	2023-2025	SHSK/MD	Qendror dhe lokal	MD/Donacion	Trajnime të specializuara të realizuara

Objektivi specifik 3.2		Avancimi i mëtutjeshëm i mjeteve teknologjike dhe logjistike				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Avancimi i sistemit elektronik databaza	2023-2025	ShSK/MD	MD	MD/Donacion	Data baze e avancuar e realizuar
2.	Sigurimi i pajisjeve teknologjike dhe logjistike	2023-2025	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Paisjet e logjistike teknologjike të siguruara
3	Blerja e automjeteve	2023-2025	SHSK/MD	Qeveria /MFPT, donatorë tjerë	MD/Donacion	Automjetet e siguruara
4	Krijimi i hapësirave të punës	2023-2025	SHSK/MD	Qeveria /MFPT, donatorë tjerë	MD/Donacion	Hapsira të punës të siguruara

Objektivi specifik 3.3		Përkrahja në mirëqeniën e stafit				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Organizimi i takimeve të përbashkëta në nivel të SHSK-së	2023-2025	SHSK	MD	MD/Donacion	Takimet e realizuara
2	Të sigurohet mireqenia nga mjetet në dispozicion (logjistike, financiare etje)	2023-2025	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Aktivitete që ndihmojnë mirëqenien psikoemocionale e realizuara
3	Ofrimi i mbështetjes psikologjike	2023-2025	ShSK/MD	MD	MD/Donacion	Mbeshtetje psikologjike e realizuar



MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

